



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.1176/20

16/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: “Contrumax”SH.P.K.; N.N.SH “Top Projekt”-Suharekë, si dhe grupi i OE: “Ada Consulting Group” SH.P.K.; “Krap Com”SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Euroing”SH.P.K-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi-Faza e dytë”, me nr. të prok: 624-20-4571-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Suharekë”, më datën: 15.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHEN, si pjesërisht të bazuara ankesat e grupit të operatorëve ekonomik: “Ada Consulting Group”SH.P.K.; “Krap Com”SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi-Faza e dytë”, me nr. të prok: 624-20-4571-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Suharekë”.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi-Faza e dytë”, me nr. të prok: 624-20-4571-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Suharekë” dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: “Contrumax”SH.P.K.; N.N.SH “Top Projekt”-Suharekë, aprovohen si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

IX. Me qenë se ankesat e grupit të operatorëve ekonomik ankues: “Ada Consulting Group”SH.P.K. ; “Krapicom”SH.P.K-Prishtinë, i refuzohen si të pa bazuara, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Grupi i operatorëve ekonomik ankues: “Contrumax”SH.P.K.; N.N.SH “Top Projekt”-Suharekë, si dhe grupi i OE: “Ada Consulting Group”SH.P.K.; “Krapicom”SH.P.K-Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 30.12.2020 me nr. 1176/20, dhe me 05.01.2021 me nr. 16/21, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi-Faza e dytë”, me nr. të prok: 624-20-4571-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Suharekë”,duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 24, 28, 59, si dhe nenin 72 të LPP-së, te ankesa me nr. 1176/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59, 60, 64, 69, si dhe nenin 72 të LPP-së, te ankesa me nr. 16/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirm nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 15.01.2021, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Contrumax”SH.P.K.; N.N.SH “Top

Projekti"-Suharekë,

Përgjigje në Pretendimet ankimore (neni 113 i LPP-së) të OE ankues:

Sa i përket pretendimeve rreth shkeljeve të pretenduara të AK gjatë procesit të tenderimit, ato nuk i takojnë shqyrtimit në këtë fazë të ankimit, por janë çështje që me shumë i takojnë autoriteteve të drejtësisë. Këto pretendime trajtohen mjaftueshëm me Nenin 1, 6, 7, 24, 28, 59, 72 të LPP-së.

Sa i përket pretendimeve rreth shkeljeve të pretenduara të AK në mosrespektimin e Vendimi i OSHP-se Nr. 980-984/20 i datës 11.12.2020, siç dihet vendimet e OSHP-se janë obligative për AK, dhe kjo trajtohet me Nenin 105 të LPP-së në kuadër të Kompetencave të OSHP-së, për çka i mbetet Panelit Shqyrtues të vendosi në lidhje me të zbatueshmërinë e vendimit nga ana e AK.

Është indikator mjaft negativ se si AK, respektivisht komisioni i rivlerësimit e ka përpiluar Raportin e Rivlerësimit, i cili raport është shumë i zbrazet, pa asnjë shqyrtim analitik të pretendimeve të OE ankues dhe asnjë të dhënë rreth trajtimit të Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 i datës 11.12.2020.

Raporti i rivlerësimit përmbyllet me vetëm një fjali: "Komisioni pasi bëri rivlerësimin e ofertave të Operatoreve Ekonomik, rekomandon Zyrën e Prokurimit që të shpallë fitues "EuroIng" Shpk me çmim me të ulët prej 2,490,528.88 €".

Sa i përket pretendimit nr. 1

që OE ankues është eliminuar pa arsye lidhur me kontratën e inxhinierit të Arkitekturës Arzije Zeneli e cila ka marrëdhënie pune me OE "Top Projekt" dhe në MKRS. Eksperti Shqyrtues konsideron se për këtë çështje janë dhënë sqarimet e mjaftueshme nga OE ankues, AK gjatë rivlerësimit nuk e ka shfrytëzuar mundësinë për sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-se, andaj këtë pretendim e konsideroj "res judicata" - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980- 984/20 të datës 11.12.2020.

Sa i përket pretendimit nr. 2

që OE ankues është eliminuar pa arsye, se nuk e plotëson piken 2 Një Minibager me kapacitet 1.2 deri në 1.7 ton. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron "res judicata" - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020. Për këtë pretendim janë dhënë sqarimet e mjaftueshme gjatë shqyrtimit paraprak, AK duhet ta këtë parasysh paragrafin 6 të Nenit 28 të LPP-së (Specifikimet teknike) ku theksohet se. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuar në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk

përputhet me specifikimet teknike të formulara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni. Minibageri i ofruar nga OE ankues nuk mund të konsiderohet që nuk e kryen funksionin e kërkuar për këtë projekt, ku nga parimet baze të prokurimit është specifikimi minimal i një pajisje me qëllim të kryerjes së funksionit që kërkohet, ndërsa kur pajisja ka kapacitet më të madh – është e mirëqenë për AK. Sidoqoftë AK duhet ta këtë parasysh paragrafin 4 të nenin 59 të LPP-së, ku ky ndryshim mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk ndikon materialisht dhe nuk e cenon kualitetin e realizimit të projektit: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Sa i përket pretendimit nr. 3

që OE ankues padrejtësisht është eliminuar, lidhur me pozicionin e parë në paramasë “Pastrimi i terenit dhe shenjëzimi i vendit për ndërtimin e objektit me çmimin prej 217,000.00 €” si pozicion manipulativ dhe që nuk mund të arsyetohet me asnjë rregull e as standard inxhinierik.

Eksperti Shqyrtues konsideron se për këtë çështje janë dhënë sqarimet e mjaftueshme nga OE ankues, janë përshkruar në formë tabelore pozicionet e punimeve që duhet të kryhen dhe master plani i projektit, andaj këtë pretendim e konsideroj “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020.

Sa i përket pretendimit nr. 4

OE ankues, që Autoriteti Kontraktues padrejtësisht e ka eliminuar me arsyetimin se ka ndërhyrë në paramasë. Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i bazuar, pasi që OE ankues nuk ka ndërhyrë në paramasën e tenderit, por i ka plotësuar çmimet për njësi në (€) siç kërkohet në tenderim. Ndërsa AK në paramasën e tenderuar ka bërë disa gabime, duke lënë pozicione pa sasi fare, e në vend të tyre vendosë formula të fshehura me të cilat i ven në lajthitje për të gabuar operatorët ekonomik. Secili pozicion në paramasën e projektit duhet të përmbajë: Numrin e pozicionit, përshkrimin e pozicionit, njësinë matëse, sasinë.

Shih në Paramasën e AK për poz. A24 dhe B20

The first screenshot shows a table with columns for item description, unit, and price. The second screenshot shows a similar table with more detailed specifications and pricing.

Shih ofertën e OE ankues CONSTRUMAX SH.P.K. & N.N.SH. TOP PROJEKT për poz. A24 dhe B20

The first screenshot shows a table with columns for item description, unit, and price. The second screenshot shows a similar table with more detailed specifications and pricing.

Ne baze të dëshmive të mësipërme, paramases së tenderit dhe ofertës së OE ankues për poz. A24 dhe B20, shihet qartë se AK nuk e ka vendosur sasinë fare, ndërsa OE ka vendosur çmimin për njësi në euro. Këto gabime të AK nuk mund të korrigjohen në këtë fazë, por është dashur të korrigjohen në fazën e tenderimit, andaj OE nuk mund të penalizohet për gabimet e AK, por AK duhet të gjejë zgjidhje përmes sqarimeve shitesë për tejkalimin e këtyre defekteve dhe mos ta rrezikoj projektin.

Sa i përket pretendimit nr. 5


AK është dashur ta eliminojë OE të rekomanduar me pretendimin se ky OE nuk e ka plotësuar siç duhet FDT- Formularin e Dorëzimit të Tenderit, ku rezultoi se ka gabime aritmetike që kalojnë 21% të vlerës së ofertuar. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-së Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020.

Ne baze të krahasimeve të bëra nga dëshmitë e mëposhtë në mes paramases së projektit dhe ofertës së OE të rekomanduar, për poz. A17, A24 dhe B20, shihet qartë se ka ndërhyrje në sasinë e pozicioneve. Poz. A17 në paramasë e ka sasinë 4,960.00 ndërsa në ofertën e OE të rekomanduar 3,070.60. Poz. A24 në paramasë sasia është (€), ndërsa në ofertën e OE të rekomanduar është sasia 38,610.09. Poz. B20 në paramasë nuk ka sasi fare, ndërsa në ofertën e OE të rekomanduar është sasia 79,109.00.

Shih Paramasën e AK për poz. A17, A24 dhe B20

The first screenshot shows a table with columns for item description, unit, and price. The second and third screenshots show similar tables with more detailed specifications and pricing.

Shih ofertën e OE të rekomanduar për poz. A17, A24 dhe B20



Në paragrafin 20 të dosjes së tenderit, tek Seksioni I. Informacione për tenderuesit, specifikohet se: 20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit -20.1 Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.

Sa i përket pretendimit nr. 6

AK është dashur ta eliminojë OE të rekomanduar me pretendimin se ky OE sasitë e paramases i ka ndryshuar në ofertën e dorëzuar. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020.

E trajtuar edhe në pretendimin nr. 5 - OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar siç duhet FDT - Formularin e Dorëzimit të Tenderit, që është dokumenti kryesor i ofertës, dhe ku Pjesa II - Përshkrimi i Çmimeve është pjesë e FDT-se. Në bazë të RRUOPP neni 39. - Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm - Kusht administrative.

Sa i përket pretendimit nr. 7

AK nuk e ka eliminuar OE të rekomanduar për të cilin pretendon se është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshje për shfrytëzim të mjeteve me ISEFERI shpk, i cili është njëkohësisht edhe ofertues në këtë aktivitet të prokurimit. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020. Edhe pse një situatë e tillë specifike nuk është e cekur në legjislacionin e prokurimit, megjithatë sipas parimeve të ligjshmërisë dhe konfliktit të interesit, në këtë rast OE Euroing për të njëjtin tender është edhe bashkëpunëtor me OE ISEFERI, dhe njëkohësisht janë oponent.

Përderisa e drejta e ankimit ne secilin aktivitet është e garantuar me ligj, çfarë kuptimi do te kishte ne këtë aktivitet një ankesë e ISEFERI ndaj Euroing, përderisa kanë marrëveshje bashkëpunimi për shfrytëzim te mjeteve.

Sa i përket pretendimeve nr. 8, 9, 10

OE ankues, që OE i rekomanduar ka ofruar dokumente te nënshkruar nga persona te paautorizuar.

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020. Referuar Interpretimit Ligjor nga KRPP-së tek Pyetjet e Shpeshta, Nr. 40, ku theksohet se:

Pyetja 40. Si të veprohet në rastet kur dosja e tenderit, përfshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar? Përgjigja - Interpretimi i dhënë nga KRPP: Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent , nuk e rregullon Ligji për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.?

Sa i përket pretendimeve nr. 11

OE ankues, që OE Ada Consulting Group shpk & Krap Com shpk nuk e ka plotësuar qarkullimin me kontrata 60% te liderit te grupit. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020. OE Ada Consulting Group e ka prezantuar qarkullimin bankar 17,333,781.48€ dhe ka prezantuar edhe listën e projekteve, ku Autoriteti Kontraktues konform nenin 59 dhe 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shitesë për referencat për punimet e kryera sipas listës së projekteve të prezantuara.

Sa i përket pretendimeve nr. 12

OE ankues, që OE Ada Consulting Group shpk & Krap Com sh.p.k është i papërgjegjshëm pasi që inxhinieri i Infrastrukturës rrugore i prezantuar nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit.

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020. Autoriteti Kontraktues konform nenin 59 dhe 72


të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë për përvojën e inxhinierit të Infrastrukturës rrugore.

Sa i përket pretendimeve nr. 13


OE ankues, që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapu Com sh.p.k është i përgjegjshëm për arsye që nuk ka ofruar kamion me kran sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron të pa bazuar, pasi që pas shqyrtimit të dokumentacionit nga oferta e OE Ada Consulting Group shpk & Krapu Com sh.p.k shihet që e posedon kranin me gjatësi 25.8 metra sipas marrëveshjes me kompaninë A CON SHPK. Si duket është bërë një ngatërresë në shqyrtim të dokumentacionit në mes kranit të madh dhe një kamioni tjetër me kran me të vogël prej 20.4 metra.

Autoriteti Kontraktues konform nenin 59 dhe 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me kamionin me kran të ofruar, se a i plotëson parametrat e kërkuara sipas kërkesës së dosjes së tenderit.





Arbeitsbereiche Hauptausleger
Working range main boom
Portée flèche principale



Sa i përket pretendimit nr. 14

OE ankues, që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krap Com sh.p.k, i ka ndryshuar sasitë e paramasës ne ofertën e ofertuar. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020.

Ne baze te krahasimeve te bëra nga dëshmitë e me poshtë ne mes paramases se projektit dhe ofertës se OE te rekomanduar, për poz. A17, A24 dhe B20, shihet qarte se ka ndërhyrje ne sasi të pozicioneve. Poz. A17 ne paramase e ka sasinë 4,960.00 ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar 6,934.00 Poz. A24 ne paramase sasia është (€), ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar është sasia 37,387.10 Poz. B20 ne paramase nuk ka sasi fare, ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar është sasia 66,920.00

Shih Paramasen e AK për poz. A17, A24 dhe B20

Paramasa e AK për poz. A17, A24 dhe B20		Poz. i punës				Sasia		Çmimi		Vlera	
A17	...	4,960.00	...	...	...	...	...	...	...	...	...
A24	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...
B20	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...

...		Poz. i punës				Sasia		Çmimi		Vlera	
A17	...	6,934.00	...	...	...	...	...	...	...	...	...
A24	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...
B20	...	66,920.00	...	...	...	...	...	...	...	...	...

...		Poz. i punës				Sasia		Çmimi		Vlera	
A17	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...
A24	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...
B20	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...	...

Shih ofertën e OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapı Com sh.p.k, për poz. A17, A24 dhe B20

Poz. 1.	
---	--

Sa i përket pretendimit nr. 15

OE ankues, që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapı Com shpk pasi që ky OE ka gabim aritmetik tek pjesa e Ujësjellësit, Kanalizimi dhe Elektrikë që tejkalon vlerën 2%. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020.

Sa i përket pretendimit nr. 16

OE ankues, që OE “ISEFERI” nuk i plotëson as kushtet administrative për këtë tender. Eksperti Shqyrtues rekomandon se asnjëherë nuk është kontestuar çështja e eliminimit të OE “ISEFERI” i cili nuk është ankuar në asnjërin fazë, andaj këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020.

Përgjigje në Pretendimet ankimore (neni 113 i LPP-së) të OE ankues: Grup i Operatorëve Ekonomik ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.; Krapì Com SH.P.K-Prishtinë,


Sa i përket pretendimit nr. 1

OE ankues, që është eliminuar padrejtësisht për arsyen që lideri i grupit nuk e plotësoni qarkullimi me kontrata 60%. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020. Autoriteti Kontraktues konform nenin 59 dhe 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë, por me gjithë rekomandimin në mënyrë obligative që është dhënë në Vendimin e OSHP-se Nr. 980-984/20 i datës 11.12.2020, AK nuk e ka përfillur këtë gjë.



Sa i përket pretendimit nr. 2

OE ankues, që është eliminuar padrejtësisht për arsyen që Inxhinieri i Infrastrukturës rrugore nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020. Autoriteti Kontraktues nëse ende ka dyshime në këtë pikë, konform nenin 59 dhe 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë, por me gjithë rekomandimin e dhënë në Vendimin e OSHP-se Nr. 980-984/20 i datës 11.12.2020, AK nuk e ka përfillur këtë gjë.



Sa i përket pretendimit nr. 3

OE ankues, që është eliminuar padrejtësisht për arsyen se kamioni me kran i tipit Volvo FL 108x2 me numër të targave 01-825-MS nuk e ka gjatësinë prej 25m sipas njësisë së kërkesës por është 20.4m. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron **te pa bazuar**, pasi që pas shqyrtimit të dokumentacionit nga oferta e OE Ada Consulting Group s.hp.k & Krapì Com sh.p.k shihet që e posedon kranin me gjatësi 25.8 metra sipas marrëveshjes me kompaninë A CON SHPK.

Si duket është bere një ngatërresë ne shqyrtim te dokumentacionit ne mes kranit te madh dhe një kamioni tjetër me kran me te vogël prej 20.4 metra.

Autoriteti Kontraktues konform nenin 59 dhe 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shitesë ne lidhje me kamionin me kran te ofruar, se a i plotëson parametrat e kërkuara sipas kërkesës së dosjes së tenderit.


Sa i përket pretendimit nr. 4


OE ankues, që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e ka plotësuar Kërkesën nr. 8 - Inxhinier ose mostër i diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi i Infrastrukturës rrugore, së paku me 3 vite përvojë pune pas diplomimit”. Inxhinieri i prezantuar në CV e tij nuk përmbush kërkesën e lartcekur sepse i mungon përvoja 3 vjeçare pas diplomimit si inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë -Infrastrukturës, si dhe i mungojnë referencat. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020.

Sa i përket pretendimit nr. 5

OE ankues, qe OE i rekomanduar ka prezantuar dokumente te ofertës te nënshkruara nga persona te pa autorizuar. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020.

I tere dokumentacioni i ofertës se rekomanduar Euroing, i nënshkruar nga persona tjerë te pa autorizuar, përveç nga z. Mefail Gashi qe është drejtor-pronar sipas dëshmive nga informatat e certifikatës se biznesit, janë dokumente te pa vlefshme ne oferte. Ne baze te dokumentacionit te ofertës se dorëzuar ne tender nuk ka ndonjë dokument te autorizimit te z. Astrit Gashi ose te ndonjë personit tjetër për nënshkrim.





Sa i përket pretendimit nr. 5

OE ankues, që kamioni i prezantuar nga OE i rekomanduar, me targa 639-KS-229, është me regjistrim të skaduar dhe që nuk plotëson kërkesën në lidhje me mjetet e kërkuara.

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020.

Sa i përket pretendimit nr. 6

OE ankues, që kamioni i prezantuar nga OE i rekomanduar, me targa 639-KS-229, është me regjistrim të skaduar dhe që nuk plotëson kërkesën në lidhje me mjetet e kërkuara. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020.

Sa i përket pretendimit nr. 7

OE ankues, ne lidhje me marrëveshjen për shfrytëzim të mjeteve ne mes OE te rekomanduar dhe OE ISEFERI sh.p.k, i cili është njëkohësisht edhe ofertues në këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020. Ky pretendim është trajtuar edhe ne pretendimin nr. 7 te OE Construmax sh.p.k & NNSH TOP Projekt.

Sa i përket pretendimit nr. 8

OE ankues, ne lidhje me eliminimin e OE Construmax sh.p.k & N.N.SH TOP Projekt për inxhinieren e Arkitekturës Arziye Zeneli. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020. AK nëse ka dyshime, konform nenin 59 dhe 72 të LPP-së, mund të kërkoj sqarime shtesë për këtë çështje.

Sa i përket pretendimit nr. 9

OE ankues, ne lidhje me OE Construmax sh.p.k & NNSH TOP , sa i përket çmimit te ofruar tek pozicioni “Pastrimi i terenit dhe shenjezi i vendit për ndërtimin e objektit me çmimin prej 217,000.00 €”. Eksperti Shqyrtues konsideron se për këtë çështje janë dhënë sqarimet e mjaftueshme nga OE ankues, janë përshkruar ne forme tabelare pozicionet e punimeve qe duhet te kryhen dhe master plani i projektit, andaj këtë pretendim e konsideroj “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit te OSHP-se Nr. 980-984/20 te datës 11.12.2020.

Sa i përket pretendimit nr. 10

OE ankues, ne lidhje me OE Construmax shpk & NNSH TOP , se ka ndërhyrë ne paramasë, se e ka prishur formulën e kalkulimit sipas paramases se projektit për pozicionet A24 dhe B20.

Eksperti Shqyrtues konsideron që ky pretendim është i pa bazuar, pasi që se kjo çështje është trajtuar tek pretendimi nr. 4 i OE Construmax shpk & NNSH TOP. AK ne paramasen e tenderuar ka bere disa gabime, duke lënë pozicione pa sasi fare, e ne vend te tyre vendose formula te fshehura me te cilat i ven ne lajthitje për te gabuar operatorët ekonomik. Secili pozicion ne paramasen e projektit duhet te përmbajë: Numrin e pozicionit, përshkrimin e pozicionit, njësinë matëse, sasinë.

Shih ne Paramasen e AK për poz. A24 dhe B20



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

Shih ofertën e OE ankues CONSTRUMAX SH.P.K.]
& N.N.SH. TOP PROJEKT për poz. A24 dhe B20

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----

Ne baze të dëshmive të mësipërme, paramases së tenderit dhe ofertës së OE ankues për poz. A24 dhe B20, shihet qartë se AK nuk e ka vendosur sasinë fare, ndërsa OE ka vendosur çmimin për njësi në euro. Këto gabime të AK nuk mund të korrigjohen në këtë fazë, por është dashtë të korrigjohen në fazën e tenderimit, andaj OE nuk mund të penalizohen për gabimet e AK, por AK duhet të gjejë zgjidhje përmes sqarimeve shtesë për tejkalimin e këtyre defekteve dhe mos ta rrezikoj projektin.

Konstatim i përgjithshëm:

Bazuar në çka u tha më lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore të OE Ada Consulting Group shpk & Krapu Com, ndaj OE të rekomanduar janë pjesërisht të bazuara, ndërsa pretendimet ankimore ndaj OE Construmax sh.p.k & N.N.SH TOP Projekt janë të pa bazuara dhe të trajtuara me vendimin e OSHP-së Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020. Oferta Ada Consulting Group sh.p.k & Krapu Com është administrativisht e pa përgjegjshëm për arsyet si më poshtë:

Mos plotësim siç duhet të FDT- Përshkrimit të çmimeve, Ndryshim i sasive në paramasën e projektit, Gabime aritmetikore mbi 2%, Bazuar në çka u tha më lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore të OE ankues Construmax sh.p.k & NNSH TOP Projekt janë të bazuara sepse AK ka rekomanduar për kontratë OE Euroing, më i shtrenjtë për 248,104.66 € dhe i cili administrativisht është i pa përgjegjshëm për arsyet si më poshtë: Mos plotësim siç duhet të FDT- Përshkrimit të çmimeve, Ndryshim i sasive në paramasën e projektit, Gabime aritmetikore mbi 21%, Dokumentacioni i ofertës i nënshkruar nga persona të pa autorizuar, Marrëveshja me ISEFERI për shfrytëzim të makinerisë, OE ankues Construmax sh.p.k & NNSH TOP Projekt është i përgjegjshëm, por me disa devijime të cilat AK mund të trajtoj si devijime të vogla konform nenit 59.4 të LPP-së, me qëllim të mos dështimit të projektit. AK gjatë procesit të rivlerësimit nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së Nr. 980-984/20, nuk e ka respektuar nenin 1, 6, 7, 59, 60, 67, 69 dhe 72 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Referenca nga MKRS

Sipas kërkesës se FDT , ne piken 2. është kërkuar Një (1) Minibager me kapacitet nga 1.2 t deri 1.7 ton, ashtu qe operatori ekonomik nuk e plotëson këtë kriter pasi qe ne dud doganor minibageri I kërkuar peshon 1860kg, sipas marrëveshjes se prezantuar ne dosjen e tenderit për pajisjen e ka plotësuar qe është 1.2 deri 1.7 TON, mirëpo dudi doganor qe i përket kësaj pajisje është mbi 1.86 TON.(nuk e plotëson kriterin e kërkesës).

Kërkesa 10 - Paisjet e nevojshme për kryerjen e këtij projekti 1. Eskavator me kapacitet mbi 18 ton, minimumi 2 copë, 2. Një (1) Minibager me kapacitet nga 1.2 t deri 1.7 ton, 3. Një (1) Eskavator (SKIP) me dy luge maksimumi 8.5 Ton, 4. Kamion lëper me kapacitet mbi 12 ton, minimumi 2 copë, 5. Një (1) Kamion me kran, gjatësia e kranit minimumi 25 Metra.	Dëshmia 10 - Dëshmi mbi posedimin e paisjeve, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofrohet (Librezat kopje, Dokumentin Unik Doganor për makinë që është Librezat, Faturat e blerjes me dëshmi bankare). Nëse OE ka Marrëveshjet për shfrytëzim të paisjeve, OE duhet të ofroj Marrëveshjen për këtë Projekt për shfrytëzim të paisjeve dhe dëshmin mbi paisjet si (kopjen e librezave, Dokumentin Unik Doganor për makinë që nuk kanë Librezat, faturat e blerjes me dëshmi bankare).
---	--

Kërkesa 10 - Paisjet e nevojshme për kryerjen e këtij projekti 1. Eskavator me kapacitet mbi 18 ton, minimumi 2 copë, 2. Një (1) Minibager me kapacitet nga 1.2 t deri 1.7 ton, 3. Një (1) Eskavator (SKIP) me dy luge maksimumi 8.5 Ton, 4. Kamion lëper me kapacitet mbi 12 ton, minimumi 2 copë, 5. Një (1) Kamion me kran, gjatësia e kranit minimumi 25 Metra.		Dëshmia 10 - Dëshmi mbi posedimin e paisjeve, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofrohet (Librezat kopje, Dokumentin Unik Doganor për makinë që është Librezat, Faturat e blerjes me dëshmi bankare). Nëse OE ka Marrëveshjet për shfrytëzim të paisjeve, OE duhet të ofroj Marrëveshjen për këtë Projekt për shfrytëzim të paisjeve dhe dëshmin mbi paisjet si (kopjen e librezave, Dokumentin Unik Doganor për makinë që nuk kanë Librezat, faturat e blerjes me dëshmi bankare).	
---	--	--	--

Kapaciteti teknik dhe profesional

Dudi doganor nr.1

Kërkesa 10 - Paisjet e nevojshme për kryerjen e këtij projekti 1. Eskavator me kapacitet mbi 18 ton, minimumi 2 copë, 2. Një (1) Minibager me kapacitet nga 1.2 t deri 1.7 ton, 3. Një (1) Eskavator (SKIP) me dy luge maksimumi 8.5 Ton, 4. Kamion lëper me kapacitet mbi 12 ton, minimumi 2 copë, 5. Një (1) Kamion me kran, gjatësia e kranit minimumi 25 Metra.		Dëshmia 10 - Dëshmi mbi posedimin e paisjeve, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofrohet (Librezat kopje, Dokumentin Unik Doganor për makinë që është Librezat, Faturat e blerjes me dëshmi bankare). Nëse OE ka Marrëveshjet për shfrytëzim të paisjeve, OE duhet të ofroj Marrëveshjen për këtë Projekt për shfrytëzim të paisjeve dhe dëshmin mbi paisjet si (kopjen e librezave, Dokumentin Unik Doganor për makinë që nuk kanë Librezat, faturat e blerjes me dëshmi bankare).	
---	--	--	--

Constructmax SLPK gjatë shfrytëzimit të njetëve të punës së marrur në shfrytëzimin e njetëve me të dhëna:

Mini eskavator 1.7 ton, Marka Valoro, Tipi Ee, nr i shiritit VCEBC18CV0002585

Mini eskavator 1.7 ton, Marka Kubota, Tipi :KX013-04-SN, nr i shiritit WKFRGFI1002256444

Dudi Doganor Nr.2

Marrëveshja e shfrytëzimit të

makineris

Pozicioni i pare ne paramase 1. Pastrimi I terrenit dhe shenjëzimi I vendit për ndërtimin e objektit ka çmimin prej 217000.00 €. Ky çmimin është manipulues dhe jo çmim I tregut , pasi qe nuk mund te arsyetohet me asnjë rregull e as standard ingjinerik duke e marre parasysh natyrën e punës qe do te kryhet sipas përshkrimit te pozicionit, krahasuar çmimet e OE te tjerë pjesëmarrës ne aktivitet shifet se te gjitha çmimet e

K O N T R O L L I D E T E R M I N A L E					K O N T R O L L I D E T E R M I N A L E				
A.5	Ventilatore-konvektore kasetore Prodhuar: GREE apo ndonje tjeter prodhuar por qe i ploteson kriteret e kerkuara me projekt Modeli: FP-102XDNET Gruar: 5.26/4.59 kW	cope	16	356.50	5,704.00				
A.6	Ventilatore-konvektore kasetore Prodhuar: GREE apo ndonje tjeter prodhuar por qe i ploteson kriteret e kerkuara me projekt Modeli: FP-85XDNET Gruar: 4.19/3.26 kW	cope	1	345.00	345.00				
A.7	Ventilatore-konvektore te parapetit Prodhuar: GREE apo ndonje tjeter prodhuar por qe i ploteson kriteret e kerkuara me projekt Modeli: FP-102SD-K Gruar: 4.7/3.4 kW	cope	2	333.50	667.00				
A.8	Ventilatore-konvektore te parapetit Prodhuar: GREE apo ndonje tjeter prodhuar por qe i ploteson kriteret e kerkuara me projekt Modeli: FP-342D-K Gruar: 2.61/1.97 kW	cope	5	319.50	1,597.50				
A.9	Radiatora te prodhuar "Enrad", se bashku me mbajtese Tip: 22/600 L=600 mm L=800 mm L=1000 mm L=1200 mm	cope	2	34.50	69.00				
A.10	Valvula F-M DN 15, prodhuar TIEMME ose te ngjashme	cope	6	7.48	44.88				
A.11	Valvula te thjeshta per radiator te kufje R-15, prodhuar TIEMME ose te ngjashme	cope	6	7.82	46.92				
A.13	Valvula te thjeshta per radiator te dalje R-15, prodhuar TIEMME ose te ngjashme	cope	6	7.13	42.78				
A.14	Gypsa PEXc-AL-PEXc me izolim, prodhuar HENCO me dimensionet:								
	Ø40x3.5	m	14	16.54	231.52				
	Ø52x3.0	m	170	9.38	1,594.60				
	Ø63x3.0	m	380	4.63	1,761.40				
	Ø75x2.0	m	184	2.60	478.40				
	Ø100x2.0	m	496	2.25	1,116.00				
A.17	Filiagu Henco PRESS per gypat, se bashku me mbajtoret fshesat dhe elementet tjera (40% e gypare)	%	4,960.00	0.40	1,984.00				
A.18	Gypat e kondensatit Ø32	m	840	3.68	3,091.20				
A.19	Valvula me bolander DN 25, prodhuar TIEMME ose te ngjashme	cope	6	15.27	91.62				
A.20	Valvula me bolander DN 52, prodhuar TIEMME ose te ngjashme	cope	4	17.48	69.92				
A.21	Gypa te cil per axonje me togat								
	DN 40	m	320	4.74	1,516.80				
	DN 52	m	45	3.59	161.55				
A.22	Izolimi gypor ARMAFLEX per gypat e cil								
	DN 40	m ²	320	1.63	521.60				
	DN 52	m ²	45	1.23	55.35				
A.23	Valvula automatike te cipro-cjef	cope	4	6.67	26.68				
A.24	Furnizimi i ujit dhe testimi i sistemit 3.5 % nga pozicioni B.1 deri B.25	%	0.1	0.04	0.04				
					Total pozicioni A				
					132,942.47				

Nderhyrja ne paramase (formule) nga ana e OE

Grupi i operatorëve Ekonomik: “Contrumax”SH.P.K.; N.N.SH “Top Projekt”-Suharekë, me datë 18.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar. Konzerciumi i jonë PAJTOHET me konstatimet e ekspertit për ekspertizën nr. 1176/20 16/21 për projektin „ Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi -Faza e dytë” me nr. prok. 624-20-4571-5-1-1, Me respekt:

Operatori Ekonomik: “Ada Consulting Group”SH.P.K. ; “Krapo Com”SH.P.K-Prishtinë, me datë 21.01.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËRGJIGJE NË EKSPERTIZËN Nr. 16/21 TË DT.18.01.2021

Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr.16/21 të dt.18.01.2021 dhe ju informojmë se NUK pajtohem me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Pajtohem me konstatimin nr.5 dhe 7 të ekspertit shqyrtues në

lidhje me pretendimet tona ankimore.

Nuk pajtohem me konstatimin nr.1 të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se në lidhje me pretendimin tonë ankimor për qarkullimin me kontrata 60% liderit të grupit, sepse vetë eksperti duke ju referuar ekspertizës paraprake dhe vendimit të OSHP-së nr.980-984/20, në të cilën ekspertizë vetë eksperti shqyrtues ka konstatuar se lista e projekteve të prezantuar e tejkalon vlerën e kërkuar, mirëpo nuk janë dorëzuar referencat apo procesverbalet e pranimit teknik dhe se AK-ja ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së. Gjithashtu edhe tani në ekspertizën e fundit eksperti shqyrtues e cek shumë qartë se nuk është përfillur vendimi i OSHP-së, ku AI<-ja është detyruar të kërkoj sqarime shtesë, mirëpo edhe përkundër këtij fakti eksperti shqyrtues nuk e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor si të bazuar. Ky veprim i ekspertit shqyrtues është diskriminim i hapur ndaj kompanisë tonë pasi që në njërin anë konstaton se nuk janë kërkuar sqarime shtesë nga AK-ja ashtu siç është cekur në vendimin e OSHP-së, ndërsa në anën tjetër nuk e cilëson si të bazuar pretendimin tonë ankimor. Nuk pajtohem me konstatimin nr.2 të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor në lidhje me inxhinierin e infrastrukturës rrugore është çështje e gjykuar “res-judicata” dhe nëse AK-ja ka ende dyshime mund të kërkoj sqarime shtesë. I njëjti ekspert ka konstatuar se nuk është përfillur vendimi i OSHP-së nr.980-984/20 në të cilin vendim është obliguar AK-ja të kërkoj sqarime shtesë. Mirëpo edhe përkundër faktit se AK-ja ka qenë e obliguar të kërkoj sqarime shtesë, eksperti shqyrtues nuk e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor të bazuar, prandaj eksperti edhe në përgjigjen për këtë pretendim ka qenë i njëanshëm dhe subjektiv. Nuk pajtohem me konstatimin nr.3 të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor në lidhje me kamionin me kran i tipit Volvo FL 108x2 është i pa bazuar. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues nuk qëndron për faktin se vetë eksperti shqyrtues e ka pranuar se ne si OE e posedojmë kranin dhe faktikisht e ka pranuar gabimin e vet të cilin e ka bërë në ekspertizën paraprake. Eksperti shqyrtues e ka cekur shumë qartë se është bërë një ngatërresë në shqyrtim të dokumentacionit në mes të kranit të madh dhe një kamioni tjetër me kran më të vogël prej 20.4m, ndërsa e ka cekur se kompania jonë e posedon kranin me gjatësi prej 25.8metra. Eksperti shqyrtues në këtë rast bie në kundërshtim me vete pasi që në njërin anë konstaton se pretendimi ynë ankimor është i pa bazuar, ndërsa në anën tjetër e cek se ne e posedojmë kranin me gjatësinë e kërkuar. Gjithashtu eksperti shqyrtues e ka cilësuar si të pa bazuar edhe pretendimin e OE ankues

Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt përkitazi me kranin, ku e ka cekur se ne si OE e posedojmë kranin me gjatësinë e kërkuar. Andaj duke u bazuar në këtë fakt shihet qartë tendenca, subjektivizmi e madje edhe jo profesionalizmi i ekspertit shqyrtues në raport me pretendimet tona ankimore. Nuk pajtohem me konstatimin nr.4 të ekspertit shqyrtues në lidhje me CV e inxhinierit të infrastrukturës të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku këtë pretendim tonin e ka konsideruar si “res judicata” duke ju referuar ekspertizës paraprake. Ky konstatim i ekspertit

shqyrtues është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne e kemi cekur shumë qartë se inxhinierit të lartcekur i mungon përvoja 3 vjeçare pas diplomimit si inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë- Infrastrukturës. Pra në CV e inxhinierit të lartcekur shihet qartë se ka vetëm 2 vite përvojë pas diplomimit në drejtimin Infrastrukturë, ndërsa përvoja tjetër e prezantuar për inxhinierin është përvojë para diplomimit si Inxhinier i Infrastrukturës. Gjithashtu eksperti shqyrtues nuk e ka marrë parasysh fare pretendimin tonë ankimor se OE të rekomanduar për kontratë i mungojnë edhe referencat për Inxhinierin e lartcekur. Nuk pajtohem me konstatimin nr.6 të ekspertit shqyrtues në lidhje me validitetin e regjistrimit të kamionit të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku ka konstatuar se pretendimi ynë ankimor është çështje e gjykuar “res judicata” duke ju referuar ekspertizën paraprake në të cilën ekspertizë eksperti shqyrtues ka konstatuar se nuk ka qenë kërkesë e FDT-së që kamioni të jetë me regjistrim valid. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues është i pa bazuar dhe njëkohësisht absurd, sepse si ka mundësi që një mjet i komunikacionit në këtë rast kamioni të qarkullojë përderisa nuk posedon regjistrim me afat.

Nuk pajtohem me konstatimin nr.8 të ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin tonë ankimor për inxhinieren e arkitekturës Arzije Zeneli, të prezantuar nga OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt, ku eksperti shqyrtues e ka cilësuar këtë pretendim tonin ankimor si çështje të gjykuar “res judicata” duke ju referuar ekspertizës paraprake. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues nuk qëndron për faktin se ne e kemi cekur shumë qartë se sipas dokumenteve të bashkangjitur në dosjen e tenderit (referenca Nr.01-R/2020 dt.28.10.2020), ndërsa në CV ing. deklaroi se në MKRS ka punuar nga data 01.08.2013 deri 31.12.2018, me çka e njëjti ing. ka prezantuar dokumente të ndryshme të cilat bien ndesh me njëra tjetrën, ku me ligjin e zyrtarëve publik nuk mundet të themelohen dy marrëdhënie pune me orar të plotë. Pra ky pretendim ankimor është dashur të cilësohet si i bazuar nga ana e ekspertit shqyrtues. Nuk pajtohem me konstatimin nr.9 të ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin tonë ankimor për pozicionin e parë në paramasë 1. Pastrimi i terrenit dhe shenjëzimi i vendit për ndërtimin e objektit i cili ka çmimin prej 217000.00 € të vendosur nga OE Construmax sh.p.k & N.N.SIT. Top Projekt, ku eksperti shqyrtues e ka cilësuar këtë pretendim tonin ankimor si çështje e gjykuar “res judicata” duke ju referuar ekspertizës paraprake, në të cilën ekspertizë eksperti shqyrtues ka konstatuar se AK-ja nuk ka dhënë sqarime të mjaftueshme se përse është çmim manipulativ në lidhje me pozicionin e lartcekur. Konstatimi i ekspertit shqyrtues është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se në këtë rast nuk ka nevojë fare për sqarime në lidhje me çmimin e lartcekur, për faktin se përderisa nëse krahasohet çmimi i OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt me çmimet e OE të tjerë pjesëmarrës në aktivitet shihet se të gjitha çmimet e tyre janë max. 600.00 € dhe që rezulton se çmimi i ofruar nga OE = 217000.00 € është për 361 herë më i madh se çmimet OE të tjerë ofertues. Andaj duke u bazuar në këtë fakt është absurde të kërkohej sqarime tjera pasi që nuk mund të arsyetohet me asnjë rregull e

as me ndonjë standard ingjinerik ky çmim, duke e marrë parasysh natyrën e punës që do të kryhet sipas përshkrimit të pozicionit. Më këtë veprim ekspertit shqyrtues po tregon një anshmëri të plotë duke e favorizuar OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt haptas. Nuk pajtohem me konstatimin nr.10 të ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin tonë ankimor për ndërhyrjen në paramasë nga OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt, ku ekspertit shqyrtues e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor si të pa bazuar duke e cekur se OE i lartcekur nuk ka bërë ndërhyrje në paramasë, por vetëm i ka plotësuar çmimet për njësi në (€) siç kërkohet në tenderim. Gjithashtu e ka cekur se AK-ja në paramasë ka bërë gabime. Ky konstatim i ekspertit shqyrtues është i pa bazuar dhe nuk qëndron dhe njëkohësisht është konstatim favorizues për OE Construmax, pasi që vetëm është munduar të mbulojë gabimet e OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt, madje duke u munduar të fajësojë edhe AK. Ekspertit shqyrtues është dashur të konstatojë se a ka pasur ndërhyrje në paramasë nga OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt e jo të merret me kinse gabimet e AK-së, sepse gabimet eventuale të AK-së kanë mundur të korrigjohen para datës së hapjes së ofertave nëse do të kishte ndonjë vërejtje dhe parregullsi të vërtetuar nga OE. Pra OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt është OE i papërgjegjshëm sepse ka bërë ndërhyrje në paramasë ku e ka prishur formulën e kalkulimit të pozicioneve të kërkuara sipas paramasës së projektit të ngarkuar në sistem nga ana e AK-së dhe nga OE i lartcekur nuk janë të plotësuar pozicionet A24 dhe B20.

Ekspertit shqyrtues nuk e ka shqyrtuar fare pretendimin tonë ankimor kundrejt OE Construmax sh.p.k & N.N.SII. Top Projekt në lidhje me Minibagerin me kapacitet nga 1.2 t deri 1.7 ton, ku ne e kemi cekur se OE i lartcekur nuk e plotëson këtë kriter pasi që në dud doganor minibageri i kërkuar peshon 1860kg, ndërsa sipas marrëveshjes së prezantuar në dosjen e tenderit për pajisjen e ka shënuar që është 1.2 deri 1.7 TON, mirëpo dudi doganor që i përket kësaj pajisje është mbi 1.86 TON, pra nuk e plotëson kërkesën e lartcekur të FDT-së. Ekspertit shqyrtues me mos shqyrtimin e këtij pretendimi ankimor faktikisht e ka vërtetuar pretendimin tonë ankimor dhe njëherit e ka shprehur haptas favorizimin që i ka bërë OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt duke bërë konstatime të një anshme të drejtuara në favor të OE "Construmax sh.p.k & N.N.SH.

Top Projekt. Ndërsa sa i përket pretendimeve të OE ankues Construmax & Top Projekt në lidhje me ofertën tonë të cilat ekspertit shqyrtues i ka cilësuar si të bazuara, ku pretendim ka qënë se kinse ne kemi ndërhyrë në paramasë tek pozicione A.17, A.24 dhe B.20, ju sqarojmë se konstatimi i tillë nuk

qëndron, për faktin se në lidhje me pozicionin A.17 në rubrikën ku kemi pasur ta vendosim çmimin, AK-së i ka mbetur një çmim gabimisht, ndërsa ne po në atë rubrikë e kemi vendosur çmimin tonë, prandaj nuk ka ndërhyrje në paramasë tek sasi të apo njësi të. Sa i përket pozicioneve A.24 dhe B.20 ju sqarojmë se në këto pozicione nuk kemi të bëjmë me ndonjë përshkrim të punëve që do të kryhen, por në këto pozicione është dashur vetëm të përshkruhen çmimet prej disa pozicioneve që kanë qënë më lartë të vendosura çmimet. Prandaj në këto pozicione ne vetëm kemi përshkruar çmimet që është dashur të përshkruhen ashtu siç është

cekur te pozicioni ku e kemi vendosur çmimin, andaj nuk ekziston asnjë ndërhyrje në paramasë siç ka pretenduar OE ankues dhe eksperti shqyrtues. Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër se kinse ne kemi gabim aritmetik tek pjesa e Ujësjiellit, Kanalizimi dhe Elektriqa që e tejkalon vlerën 2%, të cilën eksperti shqyrtues e ka cilësuar si të bazuar, ju sqarojmë se ky konstatim i ekspertit shqyrtues është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se në ofertën tonë nuk ekziston asnjë gabim aritmetik, por eksperti shqyrtues i është referuar gabimisht kësaj çështje duke tentuar me çdo kusht të na shpall si OE i papërgjegjshëm. Sa i përket konstatimit të përgjithshëm dhe ekspertizës së ekspertit shqyrtues, ju sqarojmë se ndërmjet konstatimeve të ekspertit ka kundërthënie të shumta për faktin se tek pjesa konstatim i përgjithshëm e ka cekur se disa prej pretendimeve tona ankimore janë pjesërisht të bazuara, ndërsa disa të tjera të pa bazuara, mirëpo tek rekomandimi përfundimtar i tij ekspertit shqyrtues e ka cekur se refuzohet ankesa jonë si e pa bazuar. Pra konstatimet e ekspertit shqyrtues janë për tu habitur për faktin se disa herë e ka cekur shumë qartë se nuk është respektuar vendimi i OSHP-së nga ana e AK-së, ndërsa nuk i ka cilësuar pretendimet tona si të bazuara, kurse në një pretendim tjetër përkatësisht tek pretendimi i ynë në lidhje me kamionin me kran, eksperti shqyrtues e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor të pa bazuar ndërsa në brendi të konstatimit e cek shumë qartë se ne e posedojmë kamionin me kran më gjatësinë e kërkuar. Andaj duke u bazuar në këtë fakt shihet qartë se eksperti shqyrtues e ka pranuar gabimin e tij në njërin anë, mirëpo është mundur të mos pranojë gabimet në ekspertizën e tij pasi që nuk i ka marrë parasysh të gjitha faktet relevante për pretendimet tona ankimore. Eksperti shqyrtues ka treguar njëanshmëri të plotë, favorizim dhe subjektivizëm në raport me OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt Gjithashtu eksperti shqyrtues në konstatimin e përgjithshëm e ka cekur se OE Construmax sh.p.k & N.N.SH. Top Projekt është i përgjegjshëm por me disa devijime të vogla të cilat ka mundur AK-ja ti trajtoj si devijime të vogla, me qëllim të mos dështimit të projektit. Edhe në këtë konstatim eksperti shqyrtues është shumë kundërthënës në raport me konstatimet e tjera përkitazi me ofertën e OE Construmax sh.p.k & N.N.SII. Top Projekt, sepse i njëjti ekspert merr përgjegjësi edhe të panelit shqyrtues duke cilësuar devijime të vogla disa çështje, ndërsa në anën tjetër e merr rolin e mbrojtjes së buxhetit dhe del edhe në anën e AK-së për të mos ju dështuar projektit. Ne nuk e dijmë se eksperti shqyrtues a është i thirrur që të trajtojë pretendimet ankimore në mënyrë të drejtë dhe korrekte apo është i thirrur që të jep mendime abstrakte për mundësinë e dështimit të projektit. Për mendimin tonë eksperti shqyrtues ka dal jashtë autorizimeve që i ka sipas nenit 114 të LPP-së. Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria e jonë dhe papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Gjithashtu kërkojmë që të mbahet seancë dëgjimore në lidhje me këtë lëndë, me qëllim që të shqyrtohen në detaje pretendimet tona ankimore me gjitha faktet dhe dëshmitë konkrete. Prishtinë, 21.01.2021 Konzorciumi: Ada ConsuKing Group SH.P.K & Ki apPÇom SH«P«K Faik Krapi-Përfaqësuesi konzorciumit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.01.2020, përmes platformes zoom, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Përfaqësuesi i OE ankues "Costromax" deklaroj: "Kjo lëndë është kthyer në rivlerësim mirepo AK në kundërshtim me vendimin e OSHP na ka eliminuar neve me pika të njëjta të cilat janë çështje e gjykuar nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues. AK ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili është i papërgjegjshëm dhe ne si konzorcium mendojmë që autoriteti kontraktues nuk ka respektuar vendimin e OSHP duke rekomanduar operatorin e njëjte me cmimin me të shtrejt i cili sipas vendimit paraprak të OSHP-së është konsideruar si i papërgjegjshëm për këto arsye: nuk e ka plotësuar si duhet FDT përshkrimin e cmimëve, dmth ka vendosur përqindje në vend të euros, ka ndryshuar ndryshuar sasistë në tri pozicione nga paramasa e projektit, ka gabime aritmetike më shumë se 22% të vlerës totale, dmth mbi 530 mijë euro ka gabim aritmetik, dokumentacionin e ofertes të nënshkruar nga persona te pautorizuar, ka marrëveshje me I Seferin për shfrytzim të mjetëve ndrsa I, Seferi ka ofertuar edhe ai në këtë tender, dyshojmë se ka dokumente të falsifikuara lidhur me Kranin dhe dokumente tjera që kanë të bëjnë më OE i rekomanduar. Ndërsa OE më i lirë se ne "Ada e të tjerët" nuk ka referenca mbo 60 %, inxhinieri i prezantuar nuk e ka përvojën e kërkuar prej 3 vitëve, nuk ka prezantuar kranin ashtu sic është kërkuar mirëpo ka rpezantuar autokran, ka ndërhyrje në paramasë, nuk e ka plotësuar si duhet FDT përshkrimin e cmimëve, ka ndryshuar sasistë në paramasën e projektit, ka gabim aritmetik mbi 2%. Ndërsa neve që jemi të përgjegjshëm na ka eliminuar pa arsye që janë çështje të gjykuara. Neve na ka eliminuar për shkak të arkitektës së prezantuar e cila punion edhe në Ministri ku në arsye të eliminimit është thënë që si mund të punoj me porar të plotë në ministri dhe të ne dhe ne kemi dhënë arsye që kjo nuk paraqet problem, dhe ne poashtu kemi edhe dy arkitkte tjerë më tëpër se që është kërkuar. Arsye tjetër e eliminimit ka qenë kinse ne nuk kemi prezantuar një ekskavator me tonazh 1. 2 deri ne 1. 7. Kjo arsye nuk qëndron se ka qenë kërkesë të prezantohet vetëm një eksakvator ndërsa ne kemi prezantuar edhe një eksavator shtesë. Rasye tjetër është se ne kemi cmim manipulativ, dhe nuk na është dërguar formulari për sqarime shtesë. Arsye tjetër është kisne kopmania jonë ka bërë ndërhyrje në paramasë. Kjo arsye është e pabazë pasi që paramasa është me ato sasi që kemi ofrertu dhe nuk kemi ndryshuar asnjë gërmë, dhe ky rast është i gjykuar nga paneli shqyrtues. Si përfundim bazuar në të gjitha gjetjet dhe vendimin e OSHP, OE i rekomanduar dhe OE tjetër OE ankues janë të papaërgjegjshëm, dhe cfaredo vendimi për këtë aktivitet do të ketë pasoja tjera ligjore, pasi që ne si

konzircioum po humbin kohe dhe para dhe po verehet se kemi të bëjmë me një tender të kurdisur dhe keqpërdorim të parasë publike, andaj presim nga paneli shqyrtues që këtë aktivitet të kthejë në rigjykim dhe këto ceshtje ti konsiderojë si ceshtje të gjykuar".

Përfaqësuesi i grupit të OE ankues "Ada Consulting & Krapu shpk" deklaroi: "Ne fillimisht ju sqarojmë se qëndrojmë në tërësi pranë pretendimeve tona në ankesë dhe ju rikujtojmë se është për të dytën herë në shqyrtim. Ne si grup i OE jemi eliminuar nga AK për tri arsye: 1. se lideri i konzorciumit nuk e plotëson 60% e kërkuar të referencave që faktikisht paneli shqyrtues ka obliguar AK-në që të kërkojë sqarime shtesë për këto referenca sepse në bazë të listës së plotësuar, e që faktikisht AK nuk ka kërkuar sqarime, 2. në lidhje me inxhinierin e infrastruktures rrugore ku edhe për këtë është obliguar AK që të kërkojë sqarime e që nuk ka ndodhë, ku ne si dëshmi në ankesë kemi prezantuar dëshmitë e trustit që dëshmohet se i nëjti i ka 3 vite përvojë pune. Ai ka diplomuar në vitin 2015 dhe egzitojë dëshmitë që janë plotësuar kërkesa e AK për 3 vite, ndërsa sa i përket arsyes 3. edhe për këtë arsye është obliguar AK që të kërkojë sqarime nga ne por që edhe në këtë rast AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas ligjit dhe nuk ka zbatuar vendimin paraprak. Sa i përket raportit të ekspertit, edhe në raport vet ekspertit e ka pranuar se sa i përket arsyes së tretë të eliminimit është bërë një lëshim, sepse krani është në përputhje të plotë me kërkesën e AK-së sa i përket gjatësisë që është kërkuar 25 metra. Pajtohem gjithashtu edhe për konstatimin nr. 5 dhe 7 të ekspertit ndërsa nuk pajtohem me konstatimet tjera. Në lidhje me pretendimet e OE tjetër ankues Construmax për ndërhyrje në parametër, dhe mund të sqarojmë se nuk ka ndërhyrje në parametër, pra ka qenë i vendosur një cmim nga ana e AK-së dhe ne në këtë rubrikë ne kemi vendosur cmimin tonë, dhe kjo nuk është gabim nga ana e jonë sepse parametëra nuk mund të hartohet me cmime të AK-së., pra është një lëshim nga ana e tyre, prandaj vendosja e cmimit nga ana jonë nuk mund të konsiderohet ndërhyrje, edhe sa i përket pozicionit A 24 dhe B 20 edhe aty ne nuk kemi bërë asnjë lloj ndërhyrje por nga ana e AK ka qenë e hartuar formula e cila e ka vendosur cmimin automatikisht në pozicionin A 24 duke u bërë kalkulimi me formule. E njëjta gjë vlen edhe për pozicionin B20. edhe në këtë pozicion ka qenë formula edhe përqindja e që rezultoi se ne nuk kemi bërë ndërhyrje por ka qenë një formulë e përcaktuar nga ana e AK-së e që vetë OE Construmax ka bërë ndërhyrje duke ndryshuar formulën.

Sa i përket OE të rekomanduar për kontratë ne konsiderojmë që ai OE është i përgjegjshëm për shkak se deklarata nën betim dhe të gjitha dokumentet tjera të nënshkruara, nuk figurojnë të jenë të nënshkruara nga drejtori i kompanisë ose nga një person i autorizuar. Gjithashtu OE i rekomanduar është i përgjegjshëm se inxhinierin e infrastrukturës e ka pa 3 vite përvojë pune dhe verehet edhe nga CV e tij. Ju informojmë se ne jemi OE më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit dhe kërkojmë që të aprovohet kërkesa jonë si e bazuar dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Eksperti shqyrtues profesional z. Marmullaku në seancë deklaroj: "Qendroj prapa ekspertizës dhe jam munduar që të bëjë një ekspertizë sa më të detajuar. AK ka bërë një raport të tbshtë të rivlerësim dhe nuk ka respektuar vendimin paraprak të OSHP-së. Sa i përket pozicionëve të paramases. Paramasa është jo profesionale në radhë të parë. Nuk ka mundësi me pas pozicion me formula të fshehura, dhe ne këtë formë nuk guxon me lidhë kontratë përderisa në rubrikën e sasisë e ke lënë zero. Paramasa ka plotë gabime në sasi etj. Qysh ka shanca AK me lidhë një komtratë ku sasinë e ka zero ndërsa në fund del cmimi 37 mijë etj. Në rastet kur pozicionet përshkruhen me përqindje janë raste tjera por jo në këtë formë. Në këto pozicione ku ska pas sasis në paramasë këto pozicione janë inekzistente. Sa i përket makinërive sa i përket OE "Ada" po pajtona se e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit sa i përket kranit, pra autovinqi e plotëson këtë kërkesë madje e tejkalon. Edhe për minibagerin për "Construmax" mendoj që është plotësu pasiqë kjo kërkesë është plotësu madje është tejkalu. AK nuk ka bërë paramasën mirë dhe firmat nuk e kanë dhënë oferten si duhet".

Përfaqësuesi i AK-së z. Bytyqi deklaroj: "Paramasen e ka konstruktuar inxhinieri i makinerisë jo ndërtimtarisë. Po filloj me OE Construmax. Sa i përket inxhinieres Asrie Zeneli flet se është e punësuar me orar të plotë jo për ne të ardhmen dhe në kontratë asaj i shkruan 40 orë të plotë dmth për një fakt që është duke ndodhur dhe nuk mund të punoj në dy vende në orar të njëjtë. Poashtu i mungojnë referencat, nuk ka dëshmi në se ka punuar të Top Projekt, nuk ka dëshmi të prezantuar. Të pjesa e ekskavatorit. Paneli shqyrtues në vendimin paraprak ka rënë në lajthitje nga eksperti herën e kaluar. Nuk ka mundësi të dëshmohet tonazhi i ekskavatorit pa Dud doganor, në Dud doganor nuk i shkrun që ekskavatori e ka këtë apo atë tonazh ashtu sic edhe ka thënë eksperti. Eksperti e bën një vlerësim aty jo mja hek lugën.. po nëse ja hekish lugen ja hekish gumat ne e dijmë që e zbret tonazhin, po atehere ajo paisje më nuk është efektive, është fiktive. Në dud nuk i shkruan tonazhi sic pretendojnë eksperti dhe ankuesi. Te cmimi që e kemi cilësu si manipulativ, 217 mijë euro një pozicion pastrimi i terenit, por per cështjen e paramasës, ndërhyrjen apo jo ndërhyrjen do ta spejegoje inxhinieria. Sa i përket Ada Construction eliminimi është bërë për inxhinierin e infrastrkturës rrugore me përvojë pune 3 vite pas diplomimit ku nuk ka dokumente që i njëjti i ka këto vite, ska dëshmi që jane prezantuar. Te kamioni i tipit Kran volfo bëhet fjalë të largësia dmth targat ka gjatësi të vogël jo sipas kërkesës. Dmth keta e kanë paraqitë me foto me targa, secili autokran ka foton e vet të paraqitur ku flet për numrin e paisjes dhe gjatësinë e ekranit, ndërsa fotot tjera të katalogjeve të kranëve të ndryshme mund të paraqest gjithesecili po pasur një shenje identifikuese që lidhet me të. Kërkesa ka qenë 25 metra ndërsa është ofruar 20. 4 metra. Identifikimi tregon se nuk e ka më tepër asnje centimeter se 20. 4 metra. Sa i përket qarkullimit 60% të liderit për qarkullim, ai ka prezantuar disa projekte të cilat ne nuk e dimë ato projekte a janë kry për shkak se është punë në vazhdim, dmth kerkesa ka qenë 60% nga lideri nga momenti i publikimit të njoftimit për kontratë. E ka cmimin më të lirë por nuk do të thënë me u shpall fitues".

Ndërkaq inxhinieria e arkitekturës e cila ka hartuar paramasën në seancë sqaroj: "Pozicioni i parë të paramasa- kjo vlen për construmax që ka vendos cmim prej 217 mijë euro, ka me kry punë: ka me vendos një kontjiner, lidhjen e ores me furnizim me uje dhe elektrika vec eshte kry, pastrimi përfshin vetem pastrimin e objektit. rrethoja e punishtës vec egziston dhe nuk ka nevojë të behet sërish, dmth ka vendos cmim manipulativ. Ky projekt është hartu me konkurs projektimi ku ne bazë të ligjit në secilën fazë janë inxhinieret përkatës të cilët e bëjnë kalkulimin, llogarinë dhe projektimin. Tek pozicioni A24 është e vertetë që ka formulë, sepse pozicioni A 24 është i varur prej sasive që do të vendosen prej këtyre pozicionëve, sepse ka mu bo testimi i ujit dhe vendosja e qatyre gypave, dhe kjo shkon në përqindje dhe është sipas standartit. Ajo ka 4% për një pozicion është përqindja që e rrumbullakson exeli. OE Construmax ka ndërhyrë në paramasë. Të gabimi teknik që është vendos cmimi por ai varion, varësisht prej cmimit të gypave dhe ai cmimi i gypave, në momentin kur vendoset cmimi atëherë nxirret përqindja. OE Construmax nuk e ka vendos cmimin, ka ndërhyrë në paramasë, të gjithë OE tjerë e kanë vendos, edhe OE "Ada". Kalkluimi i totalit të kolonës më formulë e qet vlerën".

Përfaqësuesi i OE Construmax replikoj duke thënë se është paramasë që ka vënë OE në lajthitje.

Pasiqë nuk patë pyetje nga anëtarët e panelit shqyrtues, kryetari i panelit mbylli seancën dëgjimore të mbajtur përmes platformes online.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues shqyrtoj dhe analizoj pretendimet ankimore të OE ankues "Contrumax"SH.P.K.; N.N.SH "Top Projekt"-Suharekë

Sa i përket pretendimeve rreth shkeljeve te pretenduara te AK ne mosrespektimin e Vendimi i OSHP-se Nr. 980-984/20 i datës 11.12.2020, siç dihet vendimet e OSHP-se janë obligative për AK, dhe kjo trajtohet me Nenin 105 te LPP-së ne kuadër te Kompetencave te OSHP-së, për çka i mbetet Panelit Shqyrtues te vendosi ne lidhje me te zbatueshmërinë e vendimit nga ana e AK.

Sa i përket arsyes se OE ankues që janë eliminuar pa arsye lidhur me kontratën e inxhinierit të Arkitekturës Arzije Zeneli e cila ka marrëdhënie pune me OE "Top Projekt" dhe në MKRS, paneli shqyrtues sqaron se gjatë seancës për shqyrtim kryesor është sqaruar se inxhinieria në fjalë është e punësuar në MKRS me 40 ore

pune të plota. Paneli shqyrtues sqaron se nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit qe nëse një Operator Ekonomik Oferton ne këtë tender, stafi apo pajisjet e atij OE nuk duhet te jene tek OE-te tjerë qe ofertojnë apo edhe te kenë ndonjë vend tjetër te punes. Paneli shqyrtues konstaton se asnjë operator ekonomik nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë që nuk është e parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë ashtu siç parashihet tek neni 56 paragrafi 3 ku shkruan *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues është eliminuar pa arsye, se nuk e plotëson piken 2 një Minibager me kapacitet 1.2 deri në 1.7 ton., paneli shqyrtues sqaron se gjatë seancës dëgjimore është sqaruar se AK e ka eliminuar OE në fjalë për shkak se në Dud doganor të minibagerit nuk shënon pesha specifike e kërkuar, më saktësisht OE ka ofruar një bager i cili ka kapacitet më të madh sipas autoritetit kontraktues nëse merren parasysh qëndrimet e ekspertit shqyrtues që po të bëhet ndryshime bagerit si psh ti largohet luga atëherë praktikisht kemi ndryshim të paisjes dhe nuk kemi të bëjmë me paisje efektive por me një paisje fiktive e cila nuk ka funksionin e kërkuar, andaj duke pasur parasysh sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues që në mënyrë indriekte ka thënë se bageri i ofruar nuk është sipas kërkesës, dhe duke pasur parasysh sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, paneli e vlerëson si të paqëndrueshëm pretendimin ankimor dhe arsyen e eliminimit si të bazuar.

Në lidhje me pretendimin për arsye të eliminimit për pozicionin e parë në paramasë *“Pastrimi i terenit dhe shenjëzimi i vendit për ndërtimin e objektit me çmimin prej 217,000.00 €”* si pozicion manipulativ dhe qe nuk mund të arsyetohet me asnjë rregull e as standard inxhinierik, paneli shqyrtues sqaron se sipas sqarimëve të dhëna seancën dëgjimore, paneli shqyrtues ka arritur të vlerësoj se OE ankues ka paraqitur një tabelë të cilën e ka formuluar ashtu siç ka menduar vetë ndërkaq AK, saktësisht inxhinieria pjesë e hartimit të paramasës ka sqaruar se OE ankues ka me përfunduar punë siç janë: Vendosija e një kontineri, lidhjen e ores së ujit dhe rrymes me sistemin i cili tashmë vec egziston, pastrimin vetëm të objektit e jo sic pretendon OE ankues, rrethojën të cilën e ka kalkuluar OE ankues sipas AK-së vec se është dhe komuna ka paguar një shumë të mjetëve për vendosjen e saj gjatë fazës së parë, e që sipas AK në bazë të punëve që duhen kryer dhe cmimit që ka vendosur OE është një diferencë e madhe andaj kanë konsideruar se ka vendosur cmim manipulativ, gjë që pas sqarimëve ka arritur ta kuptoj edhe paneli shqyrtues, mirëpo AK nuk është dashur ta vendos kete pozicion nëse ka qene i pa nevojshëm, gjithashtu nëse OE ankues e ka dhene çmimin shume te larte ne kete pozicion marre ne total ofertën e OE ankues eshte me e lire sesa oferta e OE te rekomanduar per kontrate atëherë AK është dashur te shikoj se a ka dhëne OE ankues ne ofertën e tije çmime jo normalisht te ulëta sepse është e pa mundur te vendos çmime te tregut dhe te del me lire sesa OE i rekomanduar pasi

qe OE i rekomanduar per kontrate per këtë pozicion ka vendosur çmimin prej 500 € (pesëqind euro) ndërsa OE ankues ka vendosur çmimin prej 217,000.00 € (dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë euro), atëherë edhe OE i rekomanduar per kontrate ka mundësi te kete vendosur çmime me te larta se çmimet e tregut apo sic i quan AK – çmime manipulative.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues, që Autoriteti Kontraktues padrejtësisht e ka eliminuar me arsyetimin se ka ndërhyrë në paramasë. Paneli shqyrtues vlerëson se gjatë seancës për shqyrtim kryesor është sqaruar nga AK se paramasën e kanë hartuar me konkurs projektimi ku në secilën fazë janë inxhinieret përkatës të cilët e kanë bërë kalkulimin, llogarinë dhe projektimin. AK ka sqaruar se tek pozicioni A. 24 ka formulë dhe ky pozicion është i varuar nga pozicionit A. 1 deri ne A. 23. OE "Construmax" ka ndërhyrë në paramasë. AK kanë sqaruar se çmimi varion nga punët në pozicionet paraprake dhe nga ajo nxjerret përqindja, OE ka vendos çmimin për njësi në zero, duke ndërhyrë kështu në paramasë dhe me këtë rast nuk ka ndjekur formulën e vendosur në paramasë. Kalkulimi i totalit të kolonës me formulë, e vendos në mënyrë automatike vlerën, andaj në këtë rast vendosja e çmimit nga OE konsiderohet ndërhyrje në paramasë. Duke pasur parasysh këtë sqarim paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pa qëndrueshëm dhe është e bazuar arsyeja e eliminimit nga autoriteti kontraktues ne vendimin paraprak Paneli shqyrtues ka konstatuar ndryshe gjithmonë duke u bazuar ne sqarimet e ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit pasi qe seanca dëgjimore per shqyrtim kryesor është mbajtur pa pale per shkak te kushteve dhe rrethanave ne te cilat ndodhemi te shkaktuara nga pandemia.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se AK është dashur ta eliminoj OE te rekomanduar me pretendimin se ky OE nuk e ka plotësuar siç duhet FDT- Formularin e Dorëzimit te Tenderit, ku rezulton se ka gabime aritmetike që kalojnë 21% të vlerës së ofertuar. Paneli shqyrtues sqaron se ne baze te krahasimeve te bëra nga dëshmitë e me poshtë ne mes paramases se projektit dhe ofertës se OE te rekomanduar, për poz. A17, A24 dhe B20, shihet OE ka ndërhyrë ne sasi të pozicioneve. Poz. A17 ne paramase e ka sasinë **4,960.00** ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar **3,070.60**, Poz. A24 ne paramase sasia është (€), ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar është sasia 38,610.09 pra vet AK ka kërkuar qe te vendoset: *Furnizimi i ujit dhe testimi i sistemit 3.5 % nga pozicioni B.1 deri B.23*. Poz. B20 ne paramase nuk ka sasi fare, ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar është sasia 79,109.00, pasi qe vet AK ka kërkuar qe: *Furnizimi i ujit dhe testimi i sistemit 3.5 % nga pozicioni B.1 deri B.19*, mirëpo duke pasur parasysh faktin se AK ka sqaruar se ka një formulë në kalkulim të sasisë sipas pozicioneve, atëherë paneli shqyrtues vlerëson se OE ka plotësuar me cmim pozicionet përkatëse.

AK gjate rivlerësimit te kalkuloj siç duhet pozicionin A17 pasi qe ne dosje është vendosur sasia **4,960.00** ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar **3,070.60**, si dhe ti kalkuloj pozicionet A 24, dhe B 20.

Sa i përket pretendimëve ankimore AK nuk e ka eliminuar OE te rekomanduar për te cilin pretendon se është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshje për shfrytëzim të mjeteve me ISEFERI shpk, i cili është njëkohësisht edhe ofertues në këtë aktivitet të prokurimit. Paneli shqyrtues vlerëson se kjo çështje nuk është e specifikuar në legjislacionin për prokurim publik. Paneli shqyrtues i vlerëson si të qëndrueshme marrëveshjet e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë me OE I. Seferi, i cili nuk ka arritur të jetë fitues në këtë aktivitet të prokurimit duke qenë kështu OE të rekomanduar i cili është shpallur fitues nga AK nuk e ndalon asgjë që ti shfrytëzoj këto pajisje. Paneli shqyrtues konstaton se asnjë operator ekonomik nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë që nuk është e parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë ashtu siç parashihet tek neni 56 paragrafi 3 ku shkruan *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, që OE i rekomanduar ka ofruar dokumente të nënshkruar nga persona të paautorizuar. Paneli shqyrtues i referohet Interpretimit Ligjor nga KRPP-së tek Pyetjet e Shpeshta, Nr. 40, ku theksohet se:

Pyetja 40. Si të veprohet në rastet kur dosja e tenderit, përfshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar? Përgjigja - Interpretimi i dhënë nga KRPP: Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent, nuk e rregullon Ligji për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm, pra është i qëndrueshëm ky pretendim ankimor.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues, që OE Ada Consulting Group shpk & Krapu Com shpk nuk e ka plotësuar qarkullimin me kontrata 60% të liderit të grupit, paneli shqyrtues konstaton se nëse AK ka dilema

lidhur me kete pretendim mundet te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, që OE Ada Consulting Group shpk & Krapu Com sh.p.k është i përgjegjshëm pasi që inxhinieri i Infrastrukturës rrugore i prezantuar nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit, paneli shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i qëndrueshem pasi që OE "Ada & Krapu shpk" nuk kanë prezantuar dëshmi që inxhinieri në fjalë ka përvojën për 3 vite pune pas diplomimit. AK në seancën dëgjimore ka deklaruar se në dosjen e tenderit mund të verifikohet se inxhinieri në fjalë nuk ka ofruar dëshmi se ka përvojën e punës prej 3 viteve pas diplomimit, AK lidhur me kete pretendim mundet te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapu Com sh.p.k është i përgjegjshëm për arsye që nuk ka ofruar kamion me kran sipas kërkesës së dosjes së tenderit, Sipas OE ankues, oferta e OE Ada Consulting Group shpk & Krapu Com sh.p.k nuk posedon kranin prej 25.8 metra sipas marrëveshjes me kompaninë A CON SHPK. AK ka sqaruar se nga kamioni i prezantuar me targa me kran është 20. 4 metra ndërsa fotot tjera janë foto të katalogëve të ndryshme të cilat nuk dëshmojnë se kemi të bëjmë me kamionin e dorezuar për të plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit, AK lidhur me kete pretendim mundet te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues "Construmax", që OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapu Com sh.p.k, i ka ndryshuar sasinë e paramasës ne ofertën e ofertuar.

Ne baze te krahasimeve te bëra nga dëshmitë e me poshtë ne mes paramases se projektit dhe ofertës se OE te rekomanduar, për poz. A17, A24 dhe B20, shihet qarte se ka ndërhyrje ne sasinë e pozicioneve. Poz. A17 ne paramase e ka sasinë 4,960.00 ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar 6,934.00. Poz. A24 ne paramase sasia është (€), ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar është sasia 37,387.10. Poz. B20 ne paramase nuk ka sasi fare, ndërsa ne ofertën e OE te rekomanduar është sasia 66,920.00, mirëpo ashtu sic kanë sqaruar AK në paramasë ka një formulë e cila kalkulon cmimin sipas sasisve në pozicione, andaj OE ka plotësuar paramasën dhe nuk mund të konsiderohet se ka ndërhyrë në të, AK per te gjithë OE-te duhet ti sqaroj këto pretendime dhe ti kalkuloj ashtu siç duhet këto pozicione.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues, që Autoriteti Kontraktues nuk e ka eliminuar OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapu Com shpk pasi që ky OE ka gabim aritmetik tek pjesa e Ujësjiellit, Kanalizimi dhe Elektrikë që tejkalon vlerën 2%. AK duhet ti kalkuloj çmimet e pozicioneve dhe te beje krahasimin me çmimin total te ofertës se dhene nga OE Ada Consulting Group sh.p.k & Krapu Com.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues, që OE "ISEFERI" nuk i plotëson as kushtet administrative për këtë tender, paneli shqyrtues rekomandon se asnjëherë nuk është kontestuar çështja e eliminimit të OE "ISEFERI" i cili nuk është ankuar në asnjërën fazë, andaj edhe paneli shqyrtues nuk vlerëson se është e rëndësishme të nxjerret një konstatim lidhur me këtë pretendim ankimor për një operator ekonomik i cili nuk ka kontestuar eliminimin e tij nga pjesammarja në aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues shqyrtoj pretendimet ankimore të OE ankues Grup i Operatorëve Ekonomik ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.; Krapu Com SH.P.K-Prishtinë,

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues, që është eliminuar padrejtësisht për arsyen që lideri i grupit nuk e plotësoni qarkullimi me kontrata 60%, paneli shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshem pasi që nga shkresat e lëndës dhe sqarimet e dhëna në seancën dëgjimore është arritur në përfundim që OE ankues nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se lideri i grupit nuk arrin 60% të qarkullimit. OE ka dorëzuar listat e projektit të ekzekuturave dhe lideri i konzorciumit, ku në lista vërehen projekte që kalojnë vlerën e kërkuar, mirëpo lideri i grupit nuk ka dorëzuar referenca apo procesverbale të pranimit teknik ashtu sic është kërkuar në dosje të tenderit. AK gjatë seancës dëgjimore ka sqaruar se OE nuk ka arritur të dëshmojë me dëshmi se e plotëson qarkullimin e kërkuar nga AK mirëpo AK duhet të kërkojë sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se lidhur me këtë pretendim

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, që është eliminuar padrejtësisht për arsyen që Inxhinieri i Infrastrukturës rrugore nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit, paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor nuk është i qëndrueshem për faktin se AK në seancën dëgjimore ka sqaruar se inxhinieri në fjalë nuk ka përvojën prej tri vite pune pas diplomimit. OE ka dorëzuar CV të cilën e ka plotësuar vetë inxhinieri por nuk ka arritur që më dokumente tjera, sic janë kontratat e punës ose dëshmi nga TRUST se i njëjti nga data e diplomimit e deri me njoftimin për kontratë i plotëson 3 vite pune pas diplomimit, AK duhet të kërkojë sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se lidhur me këtë pretendim

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues, që është eliminuar padrejtësisht për arsyen se kamioni me kran i tipit Volvo FL 108x2 me numër të targave 01-825-MS nuk e ka gjatësinë prej 25m sipas njësisë së kërkesës por është 20.4m. Paneli shqyrtues e vlerëson këtë pretendim ankimor si të paqëndrueshem pasi që pas shqyrtimit të dokumentacionit nga oferta e OE Ada Consulting Group shpk & Krapu Com sh.p.k vërehet se i njëjti OE nuk posedon kranin prej 25.8 metra sipas marrëveshjes me kompaninë A CON SHPK. AK ka sqaruar se kamioni i prezantuar me targa me kran është 20.4 metra ndërsa fotot tjera janë foto të katalogëve të ndryshme të cilat nuk dëshmojnë se kemi të bëjmë me kamionin e dorëzuar për të plotësuar kërkesën e

dosjes së tenderit, AK duhet të kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 të LPP-se lidhur me këtë pretendim

Sa i përket pretendimit të OE ankues, që OE i rekomanduar ka prezantuar dokumente të ofertës të nënshkruara nga persona të pa autorizuar. Paneli shqyrtues sqaron se dokumentacioni i ofertës së rekomanduar Euroing, është i nënshkruar nga një person të cilit në shkresat e lëndës nuk i gjendet autorizimi apo nuk dihet se nënshkrimi i kujt është (a është nënshkrimi i pronarit apo i dikujt tjetër). Rrjedhimisht ky pretendim ankimor është i bazuar.

OE ankues, që kamioni i prezantuar nga OE i rekomanduar, me targa 639-KS-229, është me regjistrim të skaduar dhe që nuk plotëson kërkesën në lidhje me mjetet e kërkuara.

paneli shqyrtues këtë pretendim e konsideron si “res judicata” - referuar Ekspertizës paraprake dhe Vendimit të OSHP-se Nr. 980-984/20 të datës 11.12.2020.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, në lidhje me marrëveshjen për shfrytëzim të mjeteve në mes OE të rekomanduar dhe OE ISEFERI sh.p.k, i cili është njëkohësisht edhe ofertues në këtë aktivitet të prokurimit, paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është sqaruar edhe në pretendimin ankimor të OE ankues "Construmax & Top Projekt".

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, për eliminimin e OE Construmax sh.p.k & N.N.SH TOP Projekt për inxhinieren e Arkitekturës Arzije Zeneli, paneli shqyrtues ka dhënë përgjigje me lart lidhur me këtë pretendim.

Në lidhje me pretendimin ankimor OE ankues, në lidhje me OE Construmax sh.p.k & NNSH TOP, sa i përket çmimit të ofruar tek pozicioni “Pastrimi i terenit dhe shenjezi i vendit për ndërtimin e objektit me çmimin prej 217,000.00 €., paneli shqyrtues ka dhënë përgjigje me lart lidhur me këtë pretendim.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, se OE Construmax shpk & NNSH TOP, ka ndërhyrë në paramasë, se e ka prishur formulën e kalkulimit sipas paramasës së projektit për pozicionet A24 dhe B20, paneli shqyrtues ka dhënë përgjigje me lart lidhur me këtë pretendim.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - "KK-Suharekë",
- 1x1 OE - "Contrumax"SH.P.K.; N.N.SH "Top Projekt"-Suharekë,
- 1x1 OE: "Ada Consulting Group"SH.P.K. ; "Krapicom"SH.P.K-Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.